

KARTE TEKNOLOGJIKE PER MBJELLJEN E ULLISHTEVE

Mbjellja e ullishtes

Në projektimin e një ullishteje volumi i kurorës përbën elementin që duhet t'i referohemi dhe për këtë duhet të stabilizojmë distancat në gjërësi e lartësi në bazë të kërkesave fiziologjike dhe të formës së mbajtjes së bimës.

Kërkesa e parë është ajo e shfrytëzimit maksimal të rrezatimit diellor, që sigurohet duke zmadhuar shtrirjen e kurorës por duke evituar hijezimin në mes bimëve.

Parametri tjetër është lartësia e kurorës: ajo duhet të jetë e kufizuar për të evituar krijimin e një skeleti voluminoz.

Elementi i tretë është sipërfaqja gjethore në dispozicion të kurorës që duhet të lejojë maksimumimin e sintezës së karbohidrateve. Funkcionimi i kurorës varet pastaj nga burimet ujore e ushqyese që toka dhe klima sëbashku me shërbimet kulturore arrijnë të vënë në dispozicion.

Në kushte me 850 mm rreshje në vit volumet e kurorës arrijnë nga 11000 – 12000 m³/ha, gjithmonë në kushte të kulturës mbi ujë. Për kushtet e mbjelljes nën ujë, volumi maksimal në shumë zona të basenit mesdhetar të shtrirjes së ullirit shkon nga 13000 – 15000 m³/ha. Në kushtet tona me vëllim të kurorës rreth 12000 m³/ha, po të kemi 278 bimë/ha me distanca 6 x 6 m, volumi për bimë do të ishte 43 m³, duke krijuar nje ullishte që dominohet nga vibratorët

Menjëherë mbas përcaktimit të vëllimit, është e nevojshme stabilizimi i zhvillimit të kurorës në gjërësi dhe lartësi. re. Duke marrë lartësinë 3,4 m sipërfaqja maksimale e shtrirjes së çdo kurore do të ishte 15,9 m² baraz me një diametër 4,5 m me distancë në mes kurorave 1,5 – 2,5 m e mjaftushme kjo për qarkullimin e makinave të vjeles dhe për të evituar gjatë ditës fenomenin e hijezimit.

Zgjedhja e distancave dhe drejtimit të rreshtave

Në ullishtari distancat përfundimtare ndryshojnë në pjesën më të madhe nga 5 x 5 m në 6 x 6 m e 7 x 7 m, pa konsideruar zonat me klimë veçanërisht të favorshme në të cilën ka një zhvillim më superior se në kushte normale, që imponon distanca më të mëdha mbjelljeje.



Figura 1. Ullishte tradicionale në tarraca




Figura 2. Ullishte tradicionale

bimësh, prej 330 bimë/ha.

Distancat që shkojnë nga 5x5 m deri në 6x6 m i përgjigjen plotësisht skemës më të favorshme për t'u zbatuar nga fermeri me nr.




Figura 3. Skema të mbjelljes dhe distanca në ullishtet intensive

rrjedhjes sipërfaqësore të ujit me shpejtësi të madhe.. Edhe në projektimin e sistemeve të vaditjes duhet të kihet parasysh praktika e ruajtjes së terrenit. Si kalimi i makinerive dhe punimet duhet të behen në drejtim përpjendikular me pjerrësinë.

Sistemi pesëkëndësh është mjaft i komplikuar, kurorat kanë një ekspozim të mirë ndaj dritës në krahasim me sistemin kuadrat dhe romb.

Sistemet më efçente dhe më të zbatueshëm janë: katërkëndësh dhe romb. Sistemi katërkëndësh përdoret në raste të veçanta mekanizimi.

Projektimi i ngritjes së ullishteve dhe i sistemit të ujitjes

Në projektin e mbjelljeve të reja, drejtimi i rreshtave duhet të jetë i tillë që të pengojë flukset e mëdha të

Drenazhimi

Për kultivimin e ullirit duhet të evitohen vëndet moçalishte dhe të bëhet një drenazhim të përshtatshëm të terrenit për të parandaluar krijimin e moçaleve, veçanërisht në afërsi të trungut.

Sistemimi në formë kurrizi

Bëhet për të shmangur praninë e ujërave të ndënjura që krijohen në terrene argjilore, në terrene me horizont sipërfaqësor të papërshkueshëm.

Tarracimi

Eshtë i përshtatshëm për terrene shumë të pjerrëta. Taracimet duhet të jenë projektuar nga një ekspert.

Tarraca të vazhdueshme

Janë të përshtatshme për terrene veçanërisht të ndjeshme ndaj erozionit ose me pjerrësi shumë të madhe. Ndërtimi bëhet në formë sheshi ose me mbushje dheu, përgjithësisht të mbrojtura nga gurë ose materiale rezistente..

Punimet përgatitore

Konsistojnë në pastrimin e terrenit nga mbetjet vegetative të kulturës së mëparshme, duke përfshirë dhe shkuljen e mbetjeve të rrënjëve të pemëve, shkurreve etj, që mund të ngelen në bllok.

Faza tjetër përgatitore e rëndësishme është parashikimi i rregjimit ujqor, si në sipërfaqe dhe në thellësi.

Ulliri është veçanërisht i ndjeshëm ndaj lagështisë së tepërt dhe ndaj infeksioneve kërpudhore, të cilat në këto kushte bëhen shumë aktive duke shkaktuar kalbëzimin rrënjor.

Nëqoftëse terreni është i mbuluar me ujra, që vijnë nga terrene sipër bllokut, nevojitet të hapet një kanal i një madhësie dhe thellësie të mjaftueshme për t'i largura para se të arrijnë tek blloku i planifikuar për mbjellje. Për të evituar erozionin e tokës dhe formimin e gropave të thella për gjatë pjerrësisë së sipërfaqes, është e nevojshme të hapen në çdo 20-30m gjatësi kanale tërthore që shkarkohen në kanalet anësore.

1.Punimi i thellë i tokës

Lëvizja e tokës në thellësi është përcaktuese për t'i siguruar pjellori volumit të tokës në dispozicion për zhvillimin e aparatit rrënjor. Është shumë e nevojshme në terrene të ngjeshura. Prandaj punimi i tokës, që favorizon ajrimin dhe përmirëson strukturën, siguron mundësi të mëdha të të ushqyerit të bimës. Është më pak e rëndësishme në toka ranore ku terreni ka porozitet natyral. Në këto raste punimi mund të bëhet në thellësi më të vogla.

Periudha më e mirë e kryerjes së punimit është muaji i verës. Megjithatë mund të realizohet edhe në periudha të tjera por gjithmonë kur toka është e thatë.

Në qoftë se është planifikuar plehrim bazë është e nevojshme përmbysja para punimit të thellë që të mos vështirësohet lëvizja e traktorëve.

Terreni që i nënshtrohet shkrifërimit pëson shpërbërje të pjesëve të tokës në thellësi për shkak të agjentëve atmosferikë. Në qoftë se mbas punimit të thellë dalin në sipërfaqe gurë, ata duhet të largohen ose të coptohen.



Figura Plug qilizëm pa përmbysur tokën për mbjellje ullishte

2.Kontrolli i bimësisë spontane

Nëqoftëse me anë të punimit të thellë dhe të shkrifërimit të tokës nuk janë zhdukur barërat e egëra ato duhet të eliminohen me herbicide. Speciet që preokupojnë më shumë janë grami (cynodon dactylon), gjëmbi i bardhë (cirsium arvense) etj., të cilët janë helmues për ullinjtë

3.Mbjellja në fushë

Para mbjelljes në fushë bëhet piketimi për caktimin e pozicioneve të bimëve në tokë, duke zbatuar distancat dhe skemat e zgjedhura. Në skemën e vendosjes

katërkëndësh distanca më e madhe është e lidhur me drejtimin e lëvizjes së makinerivë bujqësore.

Në pikat ku vihet piketa hapet gropa e mbjelljes së fidanit, pasi të kemi vënë në të dy anët dy pika referimi për të gjetur pozicionin e saktë në të cilën do të formohet trugu i ardhshëm.

Përmasat e germimit, të realizuara me një tyrele ose me një bel, janë 40 cm gjerësi e thellësi.

Hapja e gropës bëhet kur toka është e thatë, veçanërisht në toka argjilore, ku në kushte të lagështisë së tepërt tyriela ngjesh tokën në anët e gropës duke formuar një shtresë të papërshkueshme që pengon shtrirjen e rregullt të rrënjëve në tokë dhe mund të provokojë asfiksi të aparatit rrënjor pasi në gropë grumbullohet ujë. Është mirë që gropat të jenë hapur përpara se sa të mbillet fidani në mënyrë që agjentët atmosferikë të përmirësojnë strukturën e tokës.

Mbi fundin e gropës fiksohet një mbështetës druri me një diametër rreth 6 cm dhe i lartë 2 m nga i cili 1.5 m mbi tokë, ose hekur me diametër 27 mm.

Në qoftë se këta mbështetës duhet të mbajnë tubat e vaditjes duhet të shtohet lartësia 0,5m. Pra, pasi hiqet vazo, bima pozicionohet me bukën e dheut 5-10 cm në nivelin e sipërfaqes së tokës. Përdoren bimë nga 18-24 muaj në vazo të paktën 3 litra, të larta 1.2-1.8 m, me kurorë e trung të rregullt të mbuluara me gjethë dhe degëzime shumë të zhvilluara.




Figura 5. Skema e vendosjes së fidanit në fushë



Figura 6. Fidani i ullirit dhe mbështetësi

aklimatizuara në vazo mund të mbillen në çdo periudhë duke garantuar ujë për ujitje.

Mbushet gropa me dhé me strukturë të mirë dhe ngjishet dheu rreth bimës.

Bima lidhet me mbështetësin me një fill plastik dhe ujitet me 10 litra ujë me qëllim që toka të krijojë një kontakt të mirë me bukën e dheut.

Në zona ku nuk ka rrezik ngricash, është mirë që mbjellja të bëhet në vjeshtë. Bimët e rritura dhe

Me mbjelljen e fidanëve në fushë, mund të instalohet edhe impianti i ujitjes me pika, i mbajtur nga fiye metalike që fiksohen në mbështetës rreth 1.9 m nga toka, për të lejuar punimin kryq të tokës, ose tubat vendosen në tokë dhe afër çdo bime nxirret një tub mbi të cilin fiksohet një sasi sprucatorësh.

Në zona ku ka kafshë brejtëse është mirë të mbrohet trungu me rrjeta metalike ose material tjetër i përshtatshëm që lehtëson përdorimin e herbicideve për kontrollin e florës spontane afër bimës dhe në rresht. Vendosja e materialit duhet të jetë e thjeshtë dhe me kosto të ulët.